



Dëshironi të njoftoheni për lajmet më të fundit nga Lajmi.net?

Jo, faleminderit

Pranoj



Kërko...



BALLINA

LAJME ▾

VIDEO

BOTA

SPORT ▾

OPINION ▾

SHOWBIZ ▾

LIFESTYLE ▾

AUTO & TEK ▾

FUN ▾

ENGLISH ▾

U përdorën AK-47 e pushkë gjuetie, zbardhen detaje të reja për vrasjen në Baks të Skenderajt

LAJME



23/07/2022 22:37



Policia e Kosovës për rajonin e Mitrovicës ka dalë me komunikatë të zgjeruar lidhur me vrasjen që ka ndodhur sot në fshatin Baks të Skenderajt.

Sipas policisë së Kosovë në rast janë përfshirë disa persona dhe si pasojë e të shtënave me armë zjarri janë plagosur tre persona, dy prej tyre janë dërguar në QKUK për trajtim, ndërsa njëri si pasojë e plagëve nga arma e zjarrit ka humbur jetën.

Policia e Kosovës gjithashtu ka njoftuar se personi i dyshuar që është dorasi ka kërkuar tretman mjekësor në QKMF në Drenas, ndërsa thuhet se është arrestuar edhe një person tjetër i dyshuar për përfshirjen në rast.

Policia ka sekuestruar dy armë: Një armë automatike AK-47 dhe një pushkë gjuetie.

Ky është njoftimi i plotë:

Sot më, 23 Korrik 2022, policia në Skenderaj ka pranuar informatën për të shtëna me armë zjarri në fshatin Baks të Skenderajt Me të pranuar informacionin, në vendin e ngjarjes me urgjencë kanë dalë të gjitha njësitet kompetente policore.

Nga informatat e para nga vendi i ngjarjes është kuptuar se në rast ishin përfshirë disa persona, ku si pasojë e të shtënave me armë zjarri tre persona ishin të plagosur. Dy persona ishin dërguar për tretman mjekësor në QKMF-Skenderaj, ku njëri prej tyre si pasojë e plagëve nga arma e zjarrit kishte humbur jetën dhe mjeku kujdestar ka konfirmuar vdekjen e tij ndërsa i plagosuri tjetër është transferuar për tretman mjekësor në Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK) në Prishtinë.

Ndërkohë policia është njoftuar se një person tjetër kishte kërkuar tretman mjekësor në QKMF në Drenas dhe pas trajtimit fillestar mjekësor, në shoqërim të policisë është dërguar për trajtim të mëtuftjeshëm në SHSKUK dhe është nën përcjelljen e policisë pasi që sipas informatave fillestare mund të jetë i dyshuar potencial në këtë rast. Gjithashtu është arrestuar edhe një person tjetër dhe do të intervistohet në cilësinë e personit të dyshuar për përfshirjen në këtë rast.

Njësia e hetimeve Rajonale ka kryer bastisje në dy lokacione dhe ka sekuestruar dy armë: një armë automatike AK-47 dhe një pushkë gjuetie. Njësia e Hetimeve Rajonale së bashku me prokurorin e shtetit janë në vendin e ngjarjes ku është duke u bërë ekzaminimi i vendit të ngjarjes dhe do të ndërmerren të gjitha veprimet e nevojshme procedurale për zbardhjen e plotë të rrethanave të këtij rasti. /Lajmi.net/

Artikuj të ngjashëm



July 25, 2022

Të shtëna me armë në një aheng në Gjilan, arrestohet 63 vjeçari



July 25, 2022

Investimi në fushën e energjisë prej 236.7 milionë dollarë, Qeveria jep...



July 25, 2022

Marrëveshja e MCC-së, arsyeya e shkuarjes së Osmanit e Kurtit në Amerikë



July 25, 2022

Presidentja Osmani dhe kryeministri Kurti udhëtojnë për në SHBA



July 25, 2022

Kosovë-Maqedoni e Veriut, me shkëmbim të mallrave prej 207 milionë eurosh



July 25, 2022

Edi Rama shkarkon Arben Ahmetaj, Belinda Balluku emërohet zv.kryeministre



info@lajmi.net
Tel: +383 49 131 131
Rr. Zenel Salihu nr. 28, zyrya nr. 5

RRJETET SOCIALE



Other Links

Fact-Checking Policy

Ethics Policy

Corrections Policy

Ownership & Funding Information

Editorial Team Information